

ORIGJINA E GJUHËS SHQIPE E REFLEKTUAR NË MBETJET GJUHËSORE TË ILIRISHTES DHE TRAKISHTES

nga **Radu Crăciun**

Çështja e origjinës së gjuhës shqipe është një temë mjaft e debatuar në hapësirën publike në Shqipëri dhe Kosovë. Ndonëse opinioni publik mbështet normalisht teorinë e prejardhjes ilire të saj, shpesh promovohen edhe teori të dyshimta, të hedhura nga diletantë të cilët deklarohen hapur si armiq të gjuhëtarëve të njohur shqiptarë Eqrem Çabej dhe Koleç Topalli, të cilët akuzohen se kanë mbështetur teorinë sipas të cilës gjuha shqipe ka një numër të madh fjalësh të huazuara nga gjuhë të tjera. E thënë ndryshe, nga padija, ata shprehin publikisht revoltën e tyre për faktin se në fjalorin etimologjik të K. Topallit, vetëm rreth 900 fjalë bazë konsiderohen si autoktone, pra i përkasin fondit pararomak të fjalëve të trashëguara nga gjuha proto-indoevropiane.

Për sa i përket çështjes së lidhjes mes gjuhës ilire dhe shqipes, është domethënëse deklarata e gjuhëtarit kosovar Rrahman Paçarizi, i cili në emisionin VOYAGE të datës 21.03.2021, (min. 19:09) me titull “Sa është e vjetër gjuha shqipe?”, tha: “Meqenëse nuk kemi dokumente të shkruara të ilirishtes dhe ka një shkëputje të madhe të vazhdimësisë, atëherë, ne, hipotezat (*lidhur me origjinën e gjuhës shqipe*) i ngremë në bazën e të dhënave të tjera, qofshin ato historike, arkeologjike, pastaj demografike, të lëvizjes së popullsisë, e të tjera”.

Padyshim që gjuha ilire njihet vetëm nëpërmjet mbetjeve gjuhësore, të cilat janë kryesisht toponime dhe antroponime të mbledhura në monografi nga gjuhëtarë jashtë Shqipërisë, si Hans Krahe, Anton Mayer dhe Ion I. Russu. Me gjithë varfërinë e materialit në gjuhën ilire, E. Çabeji gjithsesi arriti të identifikojë 26 bashkëpërkime mes termave ilirë dhe shqip, duke përfshirë tre prapashtesa specifike për gjuhën ilire.¹

Edhe pse gjuhëtarët shqiptarë e kanë mbështetur pa dallim teorinë e prejardhjes ilire, teoritë alternative nuk kanë munguar. Paraqesim më poshtë një listë e shkurtër të mbështetësve të tezave kryesore.

Teza ilire është mbrojtur kryesisht nga studiues si G. Stadtmüller, R. Katičić, A. Desnitskaja, P. Di Giovine, N. Malcolm, E. Çabej, Sh. Demiraj dhe Rr. Ismajli, teza trake nga H. Hirt, W. Tomaschek, G. Weigand, G. Schramm, H. Barić, A. Rosetti, D. Detschew, G. Reichenkron, B. P. Hasdeu, I. I. Russu, G. Brâncuș, G. Bonfante dhe M. Gabinschi. Teza dako-mize nga V. Georgiev dhe I. Duridanov kurse teza e sintezës trako-ilire nga F. Nopcsa, N. Jokl, S. Mladenov, T. Capidan dhe pjesërisht nga E. Çabej dhe G. Brâncuș. Një paraqitje më e detajuar e këtyre tezave na ofrohet nga veprat e gjuhëtarit austriak Kurt Gostentschnigg.²

Një këndvështrim të veçantë ka paraqitur gjuhëtari amerikan Eric Hamp. Ai përcakton një “fashë” që shtrihet nga pjesa veriore e Karpateve dhe që zbret në jug-perëndim, deri në Shqipërinë veriore, si një zonë ku identifikon ekzistencën e një popullsie që flet një gjuhë “protoalbanoide”, e afërt gjuhësisht si me atë dako-mize, ashtu edhe me ilirishten. Teza e Hamp-it (2007) u pranua nga Kortlandt-i (1988), i cili përdor në studimet e veta termin “dako-shqiptare”, duke e dalluar këtë idiomë nga trakishtja.

¹ E. Çabej 2017, fq. 53-58

² Gostentschnigg 2006, 2018, 2019

Kundër origjinës ilire, por edhe kundër origjinës trake të gjuhës shqipe, është shprehur në disa artikuj gjuhëtari dhe albanologu austriak Joachim Matzinger, i cili në fund të vitit 2021 ka botuar një studim mbi ilirët ku trajton edhe problemin e gjuhës ilire³. Konkluzioni i Matzinger-it është se gjuha shqipe rrjedh nga një gjuhë e Ballkanit qendror, e papërmendur në burimet historike, e ndryshme nga ilirishtja dhe trakishtja. Si territore të krijimit të protoshqiptarëve, Matzinger-i propozon një zonë mjaft të madhe, të përbërë nga provincat e *Mezisë së Epërme (Moesia Superior)*, *Dacia Ripensis*, *Dacia Mediterranea* dhe *Dardania*⁴, një tezë mjaft kontradiktore nëse kemi parasysh se këto provinca ishin të banuara me siguri nga trakë dhe ilirë. Duke qenë se qëllimi i këtij shkrimi nuk është të paraqesim me hollësi tezat mbi origjinën e gjuhës shqipe, do të kufizohemi vetëm në paraqitjen e disa aspekteve problematike, të cilat duhen pasur parasysh gjatë analizimit dhe interpretimit të mbetjeve gjuhësore të ilirishtes dhe trakishtes.

Në librin e përmendur më lart, Matzinger-i⁵ vë në dukje se mbetet gjuhësore ilire janë transmetuar përmes filtrit të folësve të latinishtes dhe greqishtes, të cilët, kur hasën fonema të panjohura për gjuhët e tyre, përdorën fonema të afërta nga repertori i gjuhës së tyre. Kështu, afrikatet *ts dhe *dz janë transkriptuar me fonemat *t* ose *s* përkatësisht *d* ose *z*. Një shembull domethënës, që pasqyron pasigurinë në riprodhimin e saktë të disa termave ballkanikë, është rasti i toponimit dako-miz *Dierna*, që ndodhet në brigjet e Danubit, i cili paraqitet edhe në format *Tierna*, *Tsierna* dhe *Zerna*. Matzinger-i vë në dukje edhe një pengesë tjetër në interpretimin e mbetjeve të gjuhës ilire, e cila vjen nga fakti se ndonjëherë emërtimet, duke ruajtur nga pikëpamja fonetike dhe morfologjike një trajtë më të vjetër, humbasin kuptimin e tyre origjinal për folësit sepse nuk kanë qenë më pjesë e zhvillimit të natyrshëm të gjuhës së folur. Përveç dy pengesave kryesore të përmendura tashmë, duhet të kihet parasysh edhe fakti që toponime ose antroponime të caktuara mund të jenë ose mbetje të trashëguara nga gjuhët e vjetra nënshtresore ose mund të huazohen nga gjuhët ndajshtrësore, të marra në kohën e bashkëjetesës e dy grupeve të ndryshme etnike. Gjithashtu duhet pasur parasysh se në një territor kaq të gjerë, siç është Gadishulli Ballkanik, ka pasur sigurisht dialekte të ndryshme të gjuhëve ilire dhe trake, dialekte të cilat nga vetë ndryshimet mes tyre përbëjnë një burim elementësh leksikorë divergjentë.

(lexoni artikullin të plotë duke klikuar këtu)

Të gjitha këto kufizime, që duhen pasur parasysh gjatë interpretimit të mbetjeve gjuhësore të ilirishtes dhe trakishtes, kërkojnë një kujdes më të madh gjatë përdorimit të këtij materiali gjuhësor për t'u krahasuar me termat protoshqiptarë të rindërtuar mbi rrënjë indoevropiane. Rrjedhimisht, hidronimi ilir i dëshmuar në formën *Rhizon* mund të ketë pasur në fakt një bashkëtingëllore afrikate, dhe, në këtë rast, duhet të ketë pasur, në kohën e përmendjes formën **Rhidzon*, kështu që nuk duhet përjashtuar afërsia me foljen shqipe *rrjedh*, si pasardhëse e një forme më të vjetër **redz*-. Gjithashtu, emri i mbretit trak *Sitas* ka pasur në lashtësi një afrikatë nistore, siç dëshmohet nga varianti *Tzittas*, i shfaqur në shek. VI, në një kohë kur grekët kishin filluar të riprodhonin këtë lloj afrikate me fonemën **tz*. E njëjta situatë vlen sigurisht edhe në rastin e termit latin *sica* “thikë”, i huazuar nga ilirishtja, ku duhet të ketë pasur formën **tsika*, që është edhe paraardhësja e termit shqip “*thikë*”.

Për sa i përket vlefshmërisë së tezës së Matzinger-it, i cili praktikisht u kundërvihet të gjithë gjuhëtarëve para tij, do të citoj konkluzionet e gjuhëtarit shqiptar Ardian Vehbiu, i cili del me këtë konkluzion: “Sa kohë që në

³ Matzinger 2006, 2009, 2012, 2016, 2016 b dhe Matzinger 2021 “Die Illyrer” (Ilirët)

⁴ Matzinger 2016 fq. 12

⁵ Matzinger 2021 fq. 142-143

Ballkan ka ekzistuar të paktën një gjuhë, ose grup gjuhësh të identifikuar si të mëvetësishme, por përndryshe të panjohura, siç janë dialektet ilire (ose, alternativisht, ato trake, dako-mize, etj.), atëherë nuk më duket shumë e arsyeshme që të shtojmë edhe një gjuhë të panjohur tjetër, për ta ancoruar aty origjinën e shqipes. Para se ta bënim këtë, duhet të përjashtojmë njëherë, me argumente gjuhësore, mundësinë që shqipja të rridhte prej ndonjërit grup gjuhësor tashmë të njohur në Ballkan, si ilirët, trakët ose dako-mizët; por argumentet që sjell Matzinger kundër autoktonisë së shqiptarëve në vijën bregdetare që nga periudha pararomake nuk ndihmojnë shumë në këtë aspekt.”⁶

Ky konkluzion i Vehbiut është veçanërisht i rëndësishëm po të marrim parasysh artikujt e botuar prej tij për origjinën e gjuhës shqipe, që mendoj se është kontributi më i çmuar i viteve të fundit nga një studiues shqiptar⁷.

Fakti që shqipja ka bashkëpërkime të konsiderueshme si me ilirishten ashtu edhe me trakishten është vënë në pah veçanërisht nga Norbert Jokl-i.⁸ Jokl-i vuri në dukje se përveç përkimeve leksikore, ka edhe përkime të rëndësishme fonetike. Megjithëse shumica e gjuhëtarëve kanë hezitur të përdorin terma të tipit “trako-ilirisht” ose “iliro-trakisht” për t’iu referuar gjuhës nga e cila ka prejardhjen gjuha shqipe, prapëseprapë mund të shtrohet teza sipas të cilës shqipja të jetë rezultat i një hibridizimi të të dyja gjuhëve. Një përzjerje e tillë mund të ketë ndodhur veçanërisht në zonat ku të dy gjuhët fqinjëronin dhe madje mbivendoseshin, përkatësisht në *Peoni (përafërsisht Maqedonia e Veriut)*, *Dardani* dhe *Mezi e Epërme*, territor që pothuajse përkon me zonën e propozuar nga Matzinger-i si territor i ngjizjes së shqiptarëve. Dëshmi në këtë drejtim na jep vetë gjuha shqipe, e cila, sipas gjuhëtarit Kolec Topalli, specialist i fonetikës historike të gjuhës shqipe, ka veçori fonetike divergjente, gjë që është tregues i një përzjerjeje të mundshme etnike të popullsisë që flisnin gjuhë të ndryshme, por të përafërta nga këndvështrimi lingvistik.⁹ Një rëndësi të veçantë, lidhur me këtë çështje, ka edhe konkluzioni i Topallit sipas të cilit: “Evolucioni i fonemave të shqipes mund të ndriçojë edhe problemin burimit të shqipes nga një gjuhë e vjetër, që është folur në Gadishullin e Ballkanit. Në këtë drejtim, në radhë të parë vjen në vështrim ilirishtja dhe pastaj trakishtja, dy gjuhë që kanë pasur edhe marrëdhënie të vazhdueshme me njëra-tjetrën për shkak të fqinjësisë së gjatë. Në mungesë të dokumenteve dhe burimeve të tjera materiale, hulumtimi i evolucionit të fonemave të këtyre gjuhëve dhe krahasimi me sistemin fonologjik të shqipes merr rëndësi të dorës së parë.”¹⁰

Është e rëndësishme të përmendet se, si teza ilire ashtu edhe ajo trake burojnë nga premisa e një simbioze të folësve të ilirishtes dhe trakishtes. Për të nënvizuar këtë fakt, do të citoj më tej nga veprat e Çabejit dhe Bariç-it, të konsideruar këtu si përfaqësues të këtyre dy tezave. Siç shihet nga citimet e mëposhtme, Çabeji pranon shprehimisht si përzjerjen e dy gjuhëve, ashtu edhe praninë e një komponenti trak në procesin e formimit të

⁶ Vehbiu 2012

⁷ Vehbiu 2007, 2012, 2020 - Vehbiu 2021: Në Ballkan, përveç fiseve helene, kanë jetuar edhe popuj të tjerë, të gjithë sot jo shumë të njohur, ngaqë nuk e kanë përdorur shkrimin: ilirët dhe trakët, por mbase edhe dako-mizët, maqedonasit e lashtë (pa lidhje me këta të tanishmit, që janë sllavë), paeonët, epirotët – nëse do t’u besojmë atyre që i mbajnë këta si të ndryshëm nga ilirët dhe nga trakët – e kështu me radhë. Madje jo vetëm në Ballkan, por edhe në trojet ku flitet sot shqipja kanë jetuar, në lashtësi, jo vetëm fise ilire, por edhe fise të tjera – të identifikuar herë si trakë, herë si epirotë. Në parim, cilido prej këtyre fiseve mund të ketë “mbijetuar” në shqiptarët e sotëm.

⁸ Ebert 1924, Albaner, Illyrer, Thraker

⁹ Topalli 2007 fq. 289 “Pra, mund të kemi të bëjmë me ndryshime të hershme dialektore në periudhën parahistorike, d.m.th. të nënës së shqipes, ose me elemente gjuhësisht të afërta, që kanë marrë pjesë në formimin e saj. Dukuri të tilla, si rezultat i përzjerjeve etnike e dialektore, nuk janë të panjohura edhe për gjuhë të tjera.”

¹⁰ Topalli 2007 fq. 426

popullit shqiptar: “Në lindje fiset ilirë mbërrinin gjer në anët e lumenjve Vardar e Moravë në Maqedoninë Veriore e në Kosovë, një trevë që në lashtësi quhej Dardania, dhe shtriheshin edhe në një pjesë të Serbisë së sotme. Në ato anë, ilirët, ishin kufi me fiset trake, vise-vise edhe duke u përzier me to”. “Për sa i përket trakëve dhe gjuhës së tyre, nisur nga dëshmia e disa të dhënave historike dhe gjuhësore (emra vendesh me tipare trake), është vënë re në kohë një prani elementësh trakë në krahun veriperëndimor të Gadishullit Ballkanik dhe veçanërisht në viset bregdetare të Adriatikut të jugut. Ato duhet të jenë përzier me kohë me elementët ilirë, pa mundur të themi se nga ilirët e trakasit kush që vendas e kush i ardhur. Si përfundim, edhe për arsye historike, mund të themi se në formimin e etnosit shqiptar në bazë qëndron elementi ilir, porse mund të ketë pasur edhe një komponent trak me përmasa gjithsesi më të vogla.”¹¹

Për të ilustruar elementët kryesorë të tezës trake të parashtruar nga Barić-i, do të paraqes dy citate nga përmbledhja e një studimi mbi historinë e gjuhës shqipe: “Ashtu siç, pas gjithë çfarë paraqitëm, gjuha shqipe është parimisht një dialekt trak, karakteri i saj trako-ilir duhet të jetë rezultat i një simbioze të mëvonshme trako-ilire, veçori që shpjegohet nëpërmjet elementëve të gjuhës ilire - që nuk janë aq të shumtë - në fjalorin e shqipes. Kështu që vetvetiu lind pyetja, kur u arrit kjo simbiozë, që shqiptarët trakas migruan në territorin gjuhësor ilir duke formuar një shtresë të re”. “Mund të supozohet se Dardania dhe Peonia ishin territoret e simbiozës së parë shqiptaro-ilire. Një numër i caktuar fjalësh ilire shpjegohen nëpërmjet ndikimit të substratit ilir.”¹²

Studimet më domethënëse që janë përpjekur të përcaktojnë si strukturën ashtu edhe përpjesëtimin etnik në zonën e kontaktit trako-ilir, si dhe evolucionin diakronik të tyre, janë ato të autorëve G. G. Mateescu, I.I. Russu, F. Papazoglou, A. Mócsy dhe Z. Mirdita¹³. Këto studime japin jo vetëm një tablo të mbetjeve gjuhësore të trakishtes dhe ilirishtes, të përfaqësuara nga antroponime, toponime, oronime dhe hidronime, por edhe të dhëna për kultet fetare të praktikuara nga vendasit, si kulti i *Kalorësit Trak*, i perëndisë trake *Zbelthurdos* ose i perëndisë ilire *Andinus*. Disa elementë kulturorë ishin të përbashkët për trakët dhe ilirët, një fakt i theksuar edhe nga Çabeji, i cili konstaton se: “Nga këta elementë etnografikë, po përmendim si një element të përbashkët fustanellën, që gjindet në Ballkan gjithkund aty ku ka ose ka pasur shqiptarë, ka qenë në përdorim edhe te Trakasit e vjetër.”¹⁴

Edhe një prezantim i shkurtër i studimeve të pesë autorëve të përmendur më lart do të shkonte përtej kornizave dhe qëllimit të këtij artikulli, andaj do të kufizohem në nxjerrjen në pah të disa konkluzioneve domethënëse për këtë artikull.

Para së gjithash, konfirmohet pozicionimi i kufirit ndërmjet ilirëve dhe trakëve në rrjedhën e lumenjve Vardar (Axios) dhe Morava (Margus), me shtesën që trakët përmenden edhe në perëndim të kësaj vije, së bashku me shumicën ilire, ashtu siç gjenden gjurmë ilire edhe në lindje të saj. Zonat në lindje të Dardanisë, të Peonisë qendrore dhe lindore, duke përfshirë territoret rreth qyteteve Naissus (Nish), Remesiana, Astibos (Shtip) dhe

¹¹ Çabej 1977, një qëndrim i përafërt edhe në Çabej 2008 fq. 14 “Në gjuhën shqipe sot kemi edhe gjurmë të ilirishtes, edhe të trakishtes, por më të shumta janë ato të ilirishtes. Pra gjuha shqipe është bijë e një dialekti të ilirishtes, por ngërthen në vete edhe disa komponentë të trakishtes.”

¹² Barić 1959, fq. 58-59

¹³ Mateescu 1925, Russu 1941, Papazoglou 1978, Mócsy 1974, Mirdita 1981

¹⁴ Çabej 2017, fq. 32

Scupi (Shkup), ishin të banuara kryesisht nga trakët, të cilët mund të konsiderohen autoktonë në këto zona.¹⁵ Në zonat perëndimore të Dardanisë, të vendosura nga autorja Fanoula Papazoglou në komunat Prizren-Gjakovë-Rahovec-Pejë dhe Prishtinë-Mitrovicë, popullsia autoktone është kryesisht ilire, por nuk mungon as elementi trak siç kuptohet për shembull nga struktura e një familjeje të përzier trako-ilire ku përveç emrave ilirë, shfaqet edhe emri trak *Sita*, babai i *Scerviaedus*.¹⁶

Konkluzioni i dytë i rëndësishëm është se duke filluar nga periudha e dominimit romak në Ballkan, konstatohet një zhvendosje të elementit trak drejt perëndimit, pa mundur të thuhet se në çfarë mase kjo zhvendosje ka ndodhur edhe drejt jugperëndimit ilir, pra në drejtim të veriut të Shqipërisë së sotme.¹⁷¹⁸ Megjithatë, një informacion në këtë kuptim na jep një mbishkrim i gjetur pranë Shkupit dhe i datuar rreth shekullit të I-II, ku përmendet qyteti *Albanopolis*, i vendosur në Shqipëri, ndoshta afër Krujës së sotme, që përmban emra me më tepër gjasa trakë, ndoshta edhe maqedonas¹⁹.

Migrimi i elementit trak drejt perëndimit dhe ndoshta jugperëndimit, duke filluar nga shek. I-VI, përbën një argument të rëndësishëm në favor të tezave të Bariç-it dhe Schramm-it dhe në të njëjtën kohë një kundër-argument ndaj argumentit kryesor të paraqitur nga ata mbështetës të tezës ilire, të cilët kanë këmbëngulur që, nga pikëpamja historike, nuk ka asnjë lëvizje të dokumentuar të popullsisë që të mund të identifikohet me proto-shqiptarët. Këtu mund të shtojmë se përveç dëshmimeve epigrafike dhe topografike, të cilat dëshmojnë emigrimin e trakëve drejt perëndimit, mund të përmendim të paktën pesë ngjarje të mëdha historike që kanë shkaktuar dhe përcaktuar emigrimin e trakëve perëndimorë, duke përfshirë fiset rrotull maleve Rodope dhe

¹⁵ Papazoglou 1978 fq. 242 “Pjesa lindore e Dardanisë, nga Shkupi deri në Naissus dhe Remesiana, në periudhën romake, ka qenë e banuar kryesisht nga një popullsi trake. Ky fakt del qartë nga analizimi i materialit onomastik.”

¹⁶ Papazoglou 1978 fq. 241, Mocsy 1974 fq. 65

¹⁷ Papazoglou 1978 fq. 244 “Pra, ndoshta duhet të marrim parasysht mundësinë e përhapjes së disa popullsive trake (*Maedi, Treves?, Dentheletai?*) në drejtim të perëndimit në periudhën kur Triballët u tërhoqën, ose ndoshta më vonë, në periudhën e përparimit romak.” - Papazoglou 1978 fq. 260 “Nëse krahasojmë analizën e mësipërme me rezultatet e ekzaminimit të toponimeve më të vjetra të Dardanisë, vërejmë një lloj mbizotërimi të emërtimeve trake tek Prokopiusi. Ka mundësi që ky fakt të reflektojë gjendjen reale dhe se në periudhën romake të vonshme ka ekzistuar faktikisht një rritje e elementit trak në dëm të atij ilir.”

¹⁸ Mateescu 1925 fq. 113-114 “Konkluzione. Nga paraqitja e mësipërme, me ndihmën e të dhënave gjeografike dhe të emrave personalë trakë të gjetur në mbishkrime, rezultojnë patjetër një përhapje shumë më e gjerë e elementëve trakë drejt perëndimit, në disa nga zonat e njohura deri tani si zona ilirike, dhe sidomos në Panoni dhe Dardani. Megjithatë, pjesa më e madhe e këtyre provave të trakizmit, datojnë nga epoka e vonë perandorake – emra vendesh nga *Itinerarii, Tabula Peutingeriana, Geogr. Ravennat, Procopius, de aedificiis*, persona trakë ose kulte trake në mbishkrimet latine të shek. II – III pas Krishtit - fakt që më bën të hamendësoj, ashtu siç e përmenda edhe më sipër, një përparim të fiseve trake në drejtim të perëndimit, duke zbritur nga Haemus dhe Rodope drejt luginave pjellore të Moravës dhe Vardarit dhe bile edhe më tej drejt Adria-s, avancim i ndodhur në kohën e zotërimit romak në dëm të fiseve autoktone ilire. Me gjasa, kjo përhapje e Trakëve në epokën perandorake, që manifestohet edhe nëpërmjet shtrirjes së treguesit *natione Bessus*, si dhe mes rolit të rëndësishëm që ata kanë luajtur në legjionet romake në kohortat e shumta dhe *alae Thracum, Dacorum* dhe *Bessorum*, në *classis Misenensis* dhe *Ravennata*, në kohortat pretoriane dhe në *numerus equitum singulariorum*, garda perandorake e Romës, vjen edhe nga fakti se pas organizimit të provincave romake dhe vendosjes së atij *pax romana*, fillon një epokë prosperiteti, duke iu dhënë fund njëherë e mirë luftërave të brendshme vëllavrasëse mes fiseve të ndryshme trake dhe ndoshta edhe disa praktikave gjakësore të treguara nga autorët klasikë lidhur me besimin e tyre fetar, me karakterin e tyre pasional dhe gjendjen e tyre semi-barbare. Për sa i përket, pra, epokës që duhet t'i përkasin këto gjurmë trake në perëndim të Gadishullit Ballkanik, arrijmë të bindemi për të kundërtën e asaj që besonte Patsch, kurse emrat e zonave më të vjetra në Dalmaci, të cituara nga ai për përpunjen fonetike të tyre me ato trake, do të mund të provonin ndoshta elementë të caktuar të përbashkët në të dyja gjuhët, trake dhe ilire, megjithëse nuk përjashtohet as prezenca më e hershme e disa fiseve trake në Adriatik.”

¹⁹ Russu 1941 fq. 118; Wilkes 1995 fq. 86; Dana 2014 fq. 120 - POSIS MESTYLU F(ILIUS) FL(AVIA) DELUS MUCATI. F(ILIA) DOM(O). ALBANOP(OLI) IPSA DELUS

Haemus: 1) Mposhtja e Besëve nga shteti klientelist i Odrisë, i mbështetur nga ushtria romake, duke filluar me kryengritjen e udhëheqësit të besëve *Volagases* në vitin 13 para Krishtit. 2) Rekrutimi masiv i të rinjve trakë në ushtrinë romake dhe përdorimi i tyre në luftërat për pushtimin e territoreve ballkanikë të lirë²⁰ 3) Dyndjet e Hunëve dhe Gotëve duke filluar nga shekulli V. 4) Dyndjet sllave në Ballkan duke filluar nga fundi i shekullit VI. 5) Fitorja e bullgarëve mbi bizantinët, pushtimi i qytetit të Serdikës në vitin 809, i ndjekur nga persekutimet e nisura kundër të krishterëve²¹.

Pasi e kemi identifikuar në vija të përgjithshme zonën e kontaktit trako-ilir, kryesisht në provincat e Peonisë dhe Dardanisë, përkatësisht - në ditët tona - Maqedonia e Veriut dhe Republika e Kosovës së bashku me rajonin lindor të Serbisë, do të vazhdojmë të merremi me materialin gjuhësor ilir dhe trak për të diskutuar rreth bashkëpërkimeve leksikore e fonetike me gjuhën shqipe. Për të pasur një ide mbi madhësinë e këtij materiali, do të përdor të dhënat e ofruara nga Russu²², sipas të cilit krahasuar me rreth 770 fjalë ilire - pa përfshirë fjalët mesape dhe ato me origjinë të pasigurt - kemi rreth 2100 fjalë dhe 130 glosa trake. Siç shihet, materiali trak është tre herë më i madh në numër se ai ilir, gjë që duhet pasur parasysh kur bëhet krahasimi sasior i bashkëpërkimeve trake me ato ilire. Përpjekjet e disa autorëve për të propozuar bashkëpërkime iliro-shqiptare përkatësisht trako-shqiptare, nuk kanë qenë as sistematike dhe as shteruese. Si Jokl-i, ashtu edhe Çabeji, Georgiev-i apo Barić-i kanë propozuar dhe analizuar një numër relativisht të vogël bashkëpërkimesh, numri më i madh është paraqitur nga Çabeji, 26 terma ilirë krahasuar me 10 terma trakë.²³ Duke përdorur, për fjalët ilire, veprat e studiuesve Krahe, Mayer dhe Russu dhe për ato trake, veprat e studiuesve Detschew dhe Dana, kam arritur të identifikoj afërsisht 120 bashkëpërkime iliro-shqiptare dhe përkatësisht 275 bashkëpërkime trako-shqiptare, në kushtet kur rreth 90 fjalë shqipe mund të lidhen sa me ilirishten aq edhe me trakishten. Përkimet e përbashkëta trako-ilire kanë një peshë prej 75% në bashkëpërkimet iliro-shqiptare, por vetëm 33% në bashkëpërkimet trako-shqiptare, fakt që shpjegohet në radhë të parë me epërsinë sasiore, por veçanërisht cilësore - 130 glosa trake - të mbetjeve gjuhësore trake krahasuar me ato ilire.

Në vijim do të paraqesim, shkurtimisht dhe me qëllim informues, bashkëpërkimet më domethënëse, pa ofruar, në parim, të dhëna mbi origjinën indoevropiane të termit dhe pa u futur - përveç ndonjë rasti përjashtimor - në analizën etimologjike, e që mbetet qëllimi i një studimi të ardhshëm.

Fjala e parë e paraqitur - një antroponim që nuk shfaqet në monografitë lidhur me mbetjet gjuhësore të trakishtes - është emri i një prifti pagan trak, *Ulkas*, biri i *Tias* (në greqisht OULK, TIOU), ndoshta një anëtar i shquar i një kulti dionisian, i cili shfaqet në dy vazo argjendi me mbishkrime, të zbuluara në një varr tumular pranë fshatit *Dragodan* në Bullgarinë perëndimore, që ndodhet midis *Germania-Pautalia* dhe *Skaptopara*.²⁴ Vendndodhja është në luginën e lumit *Struma* në zonën e fisit trak *Dentheletai*, varri daton midis viteve 134-138, në fund të mbretërimit të Hadrianit. Termi **ulka* është trajta protoshqiptare e emrit të kafshës *ujk* - emër që gjendet edhe tek ilirët në formën e toponimit *Ulqinj*, oronimit *Ulcirus* dhe antroponimit *Ulcudius*, ku prapashtesa *-di* ndoshta ka funksionin zvogëlues, në shqip *-th*, si tek *makth* - lepurush.

²⁰ Mateescu 1925 fq. 114, Speidel Michael P. A thousand tracia recruits for Mauretania Tingitana. In: *Antiquités africaines*, 11, 1977. fq. 167-173

²¹ Schramm 1993 fq. 132-133

²² Russu 1969 "Illirii" fq. 58

²³ Çabej 2017 fq. 53-58 dhe 63-66

²⁴ Theodossiev - Manov 1997

Emri i mbretit të Odrisëve *Sparadokos* - prej nga vjen edhe emri i gladiatorit të famshëm *Spartakus* - është një antroponim hibrid trako-helen, i përbërë nga varianti protoshqiptar **spara-* “farë, fis” në gjuhën e sotme shqipe, ekuivalenti i fjalës greke *sporos* “farë”, si dhe nga termi grek *-dokos* “lavdi, famë”. Semantika e emrit duhet të ketë qenë “fama e fisit / kombit”, ndoshta një fjalëndërtim në modë në ato kohë, siç dëshmohet nga antroponimet e ngjashme *Amadokus* “fama e nënës (perëndesha nënë)”, ose *Skythodokos* “fama e skitëve”. Një tregues i evoluimit specifik të gjuhës shqipe, **sp- > p- > f-*, jepet nga varianti i mëvonshëm *Pardokas*²⁵ si dhe ndoshta nga toponimi prokopian *Faranores*, ku *-nores* mund të jetë ekuivalenti latin, *honores*, i greqishtes *dokos*.

Një antroponim tjetër interesant është emri *Aparkeas*, i cili shfaqet në mozaikun e kishës paleokristiane në Mesaplik, një qytet në jug të Shqipërisë, një mozaik i shekullit të 6-të. Burri i paraqitur në mozaik mban një kapele tipike shqiptare prej leshi, një qeleshe, dhe ballin e ka të lidhur me një brez, skajet e të cilit fluturojnë pas kokës, shenjë dalluese e një prijësi. Me shumë gjasa, *a-*ja nistore në emrin *Aparkeas* është protetike, një fenomen fonetik i përhapur në rajon, siç dëshmohet nga dubletat e tipit: *Adoulkios / Doulkios, Adoulos / Doulos, Avendo / Vendo, Azimarchos / Zimarkos*,²⁶ *Atintani / Tynteni*. Kjo dukuri është e përhapur edhe tek arumunët, (vllahët), ku shfaqen fjalë si *arău* (rumanisht *rău*), *arădzimari* (rumanisht *rezemare*) ose *aluptari* (rumanisht *luptă*). Nga këndvështrimi etimologjik, emri duhet të lidhet me fjalën shqipe *i pari*, i ndjekur nga një prapashtesë tipike shqipe, **-ak / *-ke*, një element i pranishëm në fjalët e mëposhtme shqipe si: *ajkë, bark, grykë, thark, plak*. Mbaresa e emrit *Aparkeas* është identik me mbaresën e emrave trakë *Nereneas* dhe *Rolisteneas*, të cilët shfaqen në unazën e famshme të Ezerovës, Bullgari, edhe sipas emrave trakë si *Sitas, Tipas, Derdas, Zipas, Sitalkas, Derzeilas, Guras, Vezinas, Patas, Duras, Burebistas*.

Antroponime të tjerë, lidhja e të cilëve me gjuhën shqipe është e dukshme, janë: emri trak *Guras* – *gur* në shqip, *Drenis*, emër trak - *dren* në shqip; pjesa e parë e emrit të mbretit të getëve *Burebistas* – përkon me *burrë*; emri trak *Nereneas*, i përmendur më sipër, i përgjigjet emrit ilir *Neritanus*, që të dyja lidhen me *njeri*, por kuptimi fillestar ishte “burrë, trim”; emri i mbretit ilir *Ballaios*, që i përgjigjet në trakisht termit fundor - *balus*, i pranishëm në antroponime si *Dekebalus, Bardibalus, Bazobalis* dhe *Sarabalos*, të gjitha të lidhura me shqipen *ballë; Hyllus*, mbret ilir, sipas shqipes (*h*)*yll* dhe *hyj; Toskos*,²⁷ emri i një traku nga lugina e Strumës, i përmendur rreth vitit 157, i cili mund të lidhet me emrin fisnor të shqiptarëve të jugut, *Toskë; Vezinas*, emri i një prijësi dak, sipas shqipes *vjedh*, fillimisht “çoj (diçka diku)”; *Diegis*, gjeneral dak, vëllai i mbretit *Dekebalus*, përkon me *djeg; Mukaporis, Mukazenis, Mukabur*, antroponime trake, përkon me *mugull* dhe *makth* - këlysh lepuri, të dyja nga indoevropianishtja (IE) **maghos* “vajzë e re, adoleshent”; *Pataros, Patas, Patasinos, Patasios, Patumases*, antroponime trake, toponimi dak *Patavissa*, përkon me shqipen *pata* (kam, në të kryerën e thjeshtë), *pas-(ur)*, (< **pot-to*), nga indoevropianishtja **poti-s* “zotërues, pronar, sundimtar”.

Një bashkëpërkim i veçantë është dhe emri i kamomilit tek dakët, *amalusta*, i përmendur në listën e bimëve të Dioskorides-it, i cili mund të lidhet me mbiemrin shqip *i ëmbël* dhe foljen *ysht*, nga ana etimologjike e lidhur me idenë e nuhatjes / aromës. Prandaj, *amalusta* rrjedhimisht ka pasur kuptimin “e ëmbël, erëmirë”, një emër i përshtatshëm për një lule me erë të ëmbël. Edhe pse etimologjia e pjesës nistore deduktohet nga konteksti, në

²⁵ Dana 2014 fq. 141-142

²⁶ Russu 1969 fq. 153

²⁷ Sharankov 2016 fq. 59, “Crispus biri i Toskos”

këtë rast kemi të bëjmë me një situatë fatlume, sepse etimologjia mund të konfirmohet me ndihmën e toponimit get nga Dobrogea-Rumani, *Amlaidina*, vendbamin që ndodhet pranë liqenit *Tătälgeac* (Tëtëlxeak), emërtim turk me kuptimin “i ëmbël” - “*dulce*” në rumanisht, sipas edhe emrit *Dulcești*, që mban fshati afër liqenit, emër i shpjegueshëm për një liqen me ujë të ëmbël, që ndodhet pranë detit të kripur.

Fakti që emrat në gjuhën dake të bimëve janë regjistruar së bashku me ekuivalentin e tyre latin, ofron mundësinë e gjetjes së një etimologjie të motivuar semantikisht, duke u nisur nga karakteristikat e bimës. Kështu, pjesa e parë e emrit të bimës dake *sikoupnoux*, e përkthyer si “gjemb i gomarit”, duhet të përkojë me termin shqip *thikë*, **tsika* në protoshqipe, duke marrë emrin për shkak të gjetheve të mprehta dhe të lakuara, të ngjashme me thikën e lakuar të përdorur nga dakët dhe ilirët. E njëjta fjalë trako-ilire shfaqet edhe në antroponimet trake si *Sikous*, *Siku* ose *Sikelos* dhe në toponimet si *Sikla*, një fortesë në Maqedoni.

Shembuj të tjerë të emrave të bimëve dake që bashkëpërkojnë me emrat në shqip janë: *mantia* që përkon me shqipen *man*, *manaferrë*; *dun* “*hithër*”, që përkon me shqipen *dhunë*, nga indoevropianishtja **dāu-* “djeg, lëndoj, torturoj”; *toubila* “*Lewisia cotyledon*”, me *tul* - “mish, tuli i frutave”²⁸; *skiare* “gjembaç”, me *çjerr*, “gërvisht”; *diellina*, “matergona ose kruspullaku”, bimë e familjes *solanaceae*, me lule të verdha-jeshile, përkon me *diell*; pjesa fundore *-*dela* e emrave dakë *duodela*, *teudila*, *priadila*, përkojnë me shqipen *dal*, nga indoevropianishtja **dhāl-* “lulëzon, jeshilon” (lidhur me greqishten *thállo*, “lulëzon, del” dhe armenishten *dal* “barishte, bar-ilaç”); *salia* “tatulla”, emri i bimës në Dioskorides, në Detschew “bari-akrep” dhe “bima shtizë”, përkon me *thel* “peronë, shufër hekuri në të cilën varet kambana”, protoshqip **tsala*, nga IE **kel-* “shkop i hollë, shigjetë, kashtë e fortë”.

Një antroponim shumë i përhapur ilir në Dardani ishte *Andius* dhe *Andia*, kuptimi i të cilit është “Lulzim” dhe “Lule”²⁹, përkon me termat *end* “lulëzon, hapet”, *endës* “syth”, *endëz* “lule”. Prandaj, perëndia *Andinus* duhet të ketë qenë një perëndi lulesh, si Attis ose Dionisus. Një varg antroponimesh ilire me *n* dyshe ndoshta vijnë nga e njëjta rrënjë, duke qenë forma më të evoluara, sipas ndryshimit fonetik karakteristik për shqipen **nd* > *nn*: *Annaea*, *Annaeus*, *Annaia*, *Annius*, *Annula*, *Annus*.

Shembuj toponimesh, oronimesh dhe hidronimesh ilire ose trake me përkime në shqip janë: *Byllis*, një fortesë në Iliri, *Bylazora*, një fortesë në Peoni dhe ndoshta *Kabyle* në Traki, që të tria mund të përkojnë me foljen *mbyll* sipas edhe *pyle* – “porta e qytetit” në greqisht; *Cepina* emri i një kodre në rajonin e besëve, përkon me *thep* “majë e mprehtë shkëmbore”³⁰; *Mathis*, rajon malor në Shqipëri dhe *Matî*, majë mali në Bullgari, afër malit Pangaion, ndoshta edhe *Matoas*, emri i vjetër i Danubit tek getët, duhet të lidhet me *mat* “mal”, protoshqip **mata*, nga IE **mṛ-t-*; *Dimale*, vendbanim në Iliri, si dhe *Malva*, vendbanim në Daki *Malvensis*, *Kapomalva* (Procopius) në Dardani, përkon me shqipen *mal*, dhe *mal* “breg” në rumanisht; *Pelendava*, vendbanim në Daki, afër Krajovës, që përkon me *pelë*, e lidhur me *pjell*, *kopil* “bastard, shërbëtor, lastar”, nga IE **pōu-* “pak, i vogël”, “këlysh”; *Skaptensula*, një minierë ari në malet e Pangaionit, duhet lidhur me *hap* - nga ku edhe kuptimi minierë - me termin fundor *-sula* “pyll”, sipas greqishtes *hyle* “idem”, që përkon me emërtimin fisnor të *suliotëve* arvanitas, *Souloi*; *Skaptopara*, një vendbanim në Bullgarinë perëndimore, përkon me shqipen *para*, “përpara”, kuptimi i fjalës jepet sipas Detschew-it (f. 356), *para* “va, treg”, i pranishëm në përbërje të tilla si *Bessa-para*, *Bendi-para*; *Karpatet*, oronim trak që i përkon fjala *karpë* “shkëmb”; *Bratzista*,

²⁸ Detschew 1957 fq. 561

²⁹ Russu 1969 fq. 166,

³⁰ Iliev 2014 - The Ancient Thracian Origin of the Name “Cepina”

toponim i regjistruar nga Prokopi në shek. VI, që ndodhet midis *Pautalisë* dhe *Remesianës* dhe që mund të përafrohet me *bredhishte* “pyll me bredha”; **Brongos**, lumi *Margos*, sot Morava, qyteti **Brunga** në Bitini, që lidhet me *brenge* “pikëllim, shtrëngim”; **Erma**, dy lumenj, në malet Rodope dhe në Bullgarinë perëndimore, një hidronim i përafërt me *jerm*, nga IE **er-* “lëviz, trazoj”; **Carsium** “Hârshova”, **Carsidava**, përkon me *karsh, kërsh, kërrsh*, vend *karsh*, “shkëmb, vend shkëmbor”; **Kolubara, Kalabara**³¹, **Barbana**, hidronime ilire, **Zurobara, Subaris**, hidronimet dake, **Subaras**, toponim në zonën e Remesianës, me *bërrakë* “kënetë”; **Ljig** hidronimi ilir³² në jug të Beogradit, përkon me *i lig*; **Tonza**, lumi aktual *Tundzha* në Bullgari, me *tund*; **Lamatis**, toponim ilir që sipas Çabejt duhet të lidhet me *lëmë* “vend me baltë, pellg”; **Ladesta**, toponimi ilir, me *ledh*; **Stronges**, kështjellë në zonën e Remesianës, përkon me *shtrungë*; **Angros** “lumë që derdhet në lumin Strymon në zonën e Edonianëve trakë”, me *ankth*, “frikë, makth”, nga IE **anĝh-* “shtrënguar”; **Theranda** toponim ilir, sipas *ter* “thaj”, sipas emrit të sotshëm *Suhareka* që në sllavisht do të thotë “lum i thatë”; Ishulli **Sason** (Sazan) në brigjet e Shqipërisë, **Sautes** antroponimi trak, përkon me *thatë*; **Germisara, Germizera** “lumë i ngrohtë”, hidronimi në Daki, i përmendur më vonë si **Zermizerga, Zermizirga**, përkon me *zjarr, zjarrmi* “ethe, temperaturë” dhe *gjizë*, Jokl (1911 f. 28), protoshqip **gjirzə*, nga IE **ser-* “rrjedh”, sipas gr. *oros* “hirrë”, lat. *serum* “hirrë”; **Athos**, oronim në zonën jugore trake, përkon me *athët* “i thartë, thumbues”, nga IE **ak-* “i mprehtë”; **Amoulo**, toponim trak në Mezinë e Epërme, me *amull* “pellg, ujë i ndenjor”; **Daton, Datos**, toponime trake, përkojnë me *dhatë* “vendbanimi”; **Antisara**, toponim trak që do të thotë “përtej lumit”, me *anë*, “buzë”; Vendbanimi **Drubeta** në Danub, përkon me “dru”, “pemë”, *druete* “buzm” në rumanisht; **Dierna, (Tsierna, Tierna, Zerna)**, vendbanim në Danub, vendkalimi mbi akull gjatë dimrit, përkon me *cermë* “ftohtë, acar” dhe *i cermët* “i ngrirë, (për ujini)”, nga protoshqipja. **tserr-m-* < **tsern-m-*³³; **Drizupara**, toponim trak, me *drizë* “gjemb, gjembaç”; **Azetium, Adzizio** toponime trake, përkojnë me *edh* “keç”; **Stendas, Stenekorta**, toponime trak, përkojnë me *shtazë, shtanzë* “kafshë”, nga IE **stā-* “rri”; **Sterissa**, toponim trak, me *shtarët* “i hidhur”, IE *(*s*)*ter-* “i ngurtë”; **Kapi-stouras**, toponim trak, përkon me *shtroj*; **Scenopa**, hidronimi në Daki, me *hi-ri, hini* (gegërisht); **Urda**, toponim trak i rindërtuar sipas mbiemrit **Apollo Urdenos, Urdaus**, kështjellë në rajonin e Hebrusit, përkon me *hurdhë* “pellg, moçal”, *urdhë (udhos)* “gjizë”; **Kandaras** qytet në zonën e *Germene*, i lidhur me **Kandaïos**, epiteti i perëndisë Ares, përkon me *hënë*, nga IE *(*s*)*kand-* “shkëlqen, ndriçuar”; **Brento-para, Brendice**, toponime trake, **Brentoi** emër fisi ilir, ndoshta edhe Prokopi (Aed. 121, 5 Serdica), toponimi **Briparon** me pjesën nistore *bri-* dhe element të dytë *-para*, përkon me *bri*, nga IE **bhren-to-s* “dreri”; **Skuanes**, kështjellë në Dakinë mesdhetare, përkon me *hu, hunj*, protoshqip **skuna*, nga IE **sk(h)uoj-* “gjemb, gjilpërë”; **Vindenis, (Ouendenis)**, vendbanim në Dardani, **Avendo**, vendbanim dalmat, **Vendo**, antroponim ilir, përkon me shqipen *vend*; **Vedena**, një lumë në juglindje të Sofjes, **Vedea**, një degë e Danubit në Giurgiu, përkon me *ujë*, protoshqip **údenǎ*,³⁴ nga IE **ued-* “ujë”; **Tara**, hidronimi ilir, fisi ilir **Autariatai, Taras** dhe **Teres**, emra trakë, që përkojnë me *tër-*, parashtesën me kuptimin “përtej, tejshpoj” nga IE **ter-* “kaloj matanë”.

Më poshtë janë një sërë bashkëpërkimesh domethënëse, të cilat i përkasin fushave të ndryshme semantike: **Theos Salenos**, hyjni trake, **Saldokela**, emri i një burimi, epitete të perëndisë **Asklepios Saldokelenos**, përkon me *i gjallë*, protoshqip **salwa*, nga IE **sōlo-* “i plotë, i padëmtuar” dhe *gëlon* “buron, vërshon”, nga IE

³¹ Duridanov 1963 fq. 102

³² Duridanov 1963 fq. 107

³³ Pokorny fq. 573, nga një rrënjë e përfutur **ker-no-* “akull, dëborë”, Orel 1998 p. 46

³⁴ Matzinger 2007

guel(a)*- “buron”; *Salthua, Selepitani*, toponime trake, fshati *Gela* në malet Rodope, përkon me *gjellë* “ushqim i gatuar”, *gjellis* “të rrosh, të banosh”, ndoshta nga IE **sel-* “banesë, vendbanim, sallë”; *Brenai, Kebrenoi*, emër fisi trak, *Kebren*, lumë dhe fortesë në Troas, *Kebrenos*, epitete të Dionisit, përkon me *brez*, protoshqip **bren*, rumanisht *brâu* “brez”, greqisht *phren* “mendje, diafragmë”; *sarisa*, “shtizë e gjatë maqedonase”, përkon me fjalën *ther*, “shpoj”, rumanisht *țăruș* “kunj”; *Bithus, Beithus, Bitus*, antroponime trake që kanë kuptimin “bir, djalë, pasardhës”, si dhe variantet me prapashtesa të ndryshme, *Billenos, Billene*, në Epir, *Billienus, Billius*, të lidhura dhe *bilía* “bijë” në mesapishte, përkojnë me *bimë, bijë* (bilë*), *bir*, nga IE **bhei(a)* -, **bhī-* “godas, rrah”; *zalmos*, glosë trake me kuptimin “lëkurë”, *Salmoxis, (Zalmoxis)* profet get, *Zelmoutas, Zi-selmios*, si dhe *Aulu-zelmis, Diza-zelmeos, Abro-zelmis*, përkojnë me *thelmë* “rrobë, copë pëlhere”, fjalë e prejardhur nga *thelë* “fetë, copë e vogël, rrip”, protoshqip **tsalma* nga IE **kel-* “mbuloj, fsheh”; *skalme* - thikë, shpatë e shkurtër tek trakët, përkon me *helmës* – teh i mprehtë, *helm* (hidhërim), protoshqip **skalma*, nga IE **skel-* “pres, çaj”; *Kapys* “shqiponjë, skifter”, antroponim trojan, *Kapistouria, Kapidava, Kapomalva*, toponime, përkon me *kap* - rrëmbej, kuptimi i “skifter” dhe në latinisht *capys, capus*, është huazim i mundshëm nga ilirishtja; *Purrias, Pyroulas*, antroponime trake, *Pyrrmerula*, epitete të Herosit, *Spinthopyrenos*, epitete të Asklepiosit, përkon me *prush*, nga IE **peuōr* “zjarr”; *Taulantioi*, fis ilir, emri i të cilit është thënë të ketë lidhje me *dallëndyshe*;³⁵ *Mazaios, Mezenaia, Manimazos*, antroponime trake, toponimi trak *Mazaion*, antroponimi ilir *Madena, Mazzes*, antroponim mesap, përkon me mbiemrin *i madh, të mëdhenj* (sh), protoshqip **madza*, nga IE **meġ(h)-* , “i madh, shumë”, (duke marrë parasysh alternimin *d/z*, që ndodh në rastin e emrave trakë, si në *-denthes / -zenthos*, një origjinë e përbashkët mund të supozohet edhe për emrin e fisit trak *Maidoi*, fqinjë në jug me fisin *Dentheletai*); *Trausoi*, fisi trak, përkon me *i trashë*, - i shëndetshëm, i bollshëm, nga IE **treu-* “të përparosh, të rritesh”; *Bessoi, Biessoi, Diobessoi*, fiset trake, *Besiana, Besaiana*, fortesa në Dardani, *Biso* emër ilirë dhe trak, përbërësi *-bista* tek *Burebista*, e lidhur me *besë*, dhe *be(ja)*, nga IE **bheidh-*, “të kesh besim, të bindësh”, që lidhet edhe me greqishten *pistos* “besnik, besimtar” dhe sllavishten e vjetër *běda* “nevojë”; *Amlaidina, Dinogetia*, toponime gete, *Dinion*, kështjellë në Dardani, antroponime si *Dino-, Dini-bales, Dini-tralis, Zia-dinnius, Dini-bithus, Dias-dinus, Dinias*, përkon me një prototip **dina-* “fortesë, vendroje”, që mund të lidhet me *di, dije* “dituri”, nga IE **dhī-* “shikoj, vërej”, me një evoluim semantik si në gjermanisht *Wart* “kullë vrojtimi” nga *wahren* “vëzhgoj, ruaj”; *Vetespios*, emri i heroit trak, pjesa nistore *vet-* përkon me *vetë, vetja*, nga IE **sue-* “vetja”; Epitete të perëndisë Apollon, *Uneso(s)*, sipas mbishkrimit në ishullin Samothrakës [abolo uneso] *apolodore kae*, me interpretimin “*Apollodoros bëri fli për Apollon Uneso*”³⁶, të formulës së thirrjes mesape, **kla(o)hi Zis Venas** dhe emri trak *Seita-uene(os)*, duhet të lidhet me *uri(a), uni*, nga IE **uen-*, *uenə-* “synoj, dua, të jesh i kënaqur, punoj, arrij, fitoj”³⁷.

Për të theksuar dendësinë e bashkëpërkimeve me gjuhën shqipe, paraqesim një sërë termash të përbëra në të cilët të dy pjesët përbërëse kanë një përkim në gjuhën shqipe: *Kapi-stouras, Kapo-malva* (kap, shtroj, mal), *Bure-bista* (burrë, besë), *amal-usta* (ëmbël-ysht), *Skapto-para* (hap, para), *Skaptensula* (hap, suliotë), *Amlaidina* (ëmbël, di), *Muka-bur* (mugull, burrë), *Saldo-kela* (gjallë, gëlon), *Brento-para* (bri, para), *Zermi-zirga* (zjarr, gjizë).

³⁵ Illyrer Matzinger fq. 148, Eichner 2004 fq. 10

³⁶ Brixhe 2006a fq. 135, 136, Dana 2014 XLVII

³⁷ Orel 1998 fq. 489, Demiraj 1997 fq. 51; Matzinger 2006 fq. 247

Bashkëpërkimet leksikore të paraqitura më sipër, sado të shumta dhe domethënëse të jenë, megjithatë kanë një vlerë dytësore krahasuar me bashkëpërkimet fonetike. Si Jokl-i, ashtu edhe Georgiev-i, si dhe gjuhëtarë të tjerë pas tyre, janë përpjekur të identifikonin në mbetjet gjuhësore të ilirishtes dhe të trakishtes ndryshime fonetike tipike për fazën antike të shqipes. Është vënë re qysh herët se disa toponime ballkanike paraqesin evoluime fonetike specifike për shqipen, siç e përmend edhe Matzinger-i (2016 f. 17): “Nëse vërtetohet se një pjesë e toponimeve në brendësi të Ballkanit paraqesin gjurmë të një evoluimi që lidhen me shqipen – dhe vetëm? me shqipen - atëherë na rezulton se kemi të bëjmë me një tregues për një prani të hershme të shqipfolësve (albanofonëve) në atë rajon”.

Dy toponime të përmendura shpesh në këtë kontekst janë *Naissus* (Nish) dhe *Astibos* (Shtip), të dy të vendosur gjeografikisht në zonën e kontaktit trako-ilir, zonë me mbizotërim të elementit trak. Për tu vënë re është kalimi nga *Astibos* në *Shtip*, i cili paraqet tre ndryshime fonetike tipike të shqipes: rënja e *a*-së nistore të patheksuar, kalimi i grupit bashkëtingëllor *-st-* në *-sht-*, si dhe shurdhimi e buzores *b* në *p*.

Duhet nënvizuar këtu se kalimi nga *b* në *p* reflektohet gjithashtu edhe në termat trakë të zonës së Peonisë dhe Trakisë perëndimore, si në rastin e antroponimit *Parisades* nga *Berisades* dhe në rastin e emrit të bimës në gjuhën bese i përmendur si *dinupula* (*sinupula*), krahasuar me variantin dak *kinuboila* – stërkungull në shqip.

Kjo glosë bese duket se i ka shpëtuar Matzingerit, i cili thotë³⁸: “Ajo çfarë e ndërlikon lidhjen mes shqipes dhe besishtes është fakti që: (a) “trakishtja” është dëshmuar vetëm në një masë të vogël dhe *besishtja në mënyrë të veçantë është tërësisht e panjohur* dhe **sidomos** (b) evoluimi fonetik individual shqiptar dhe trak paraqet reflekse të veçanta, të cilat nuk mund të konsiderohen si rezultat i një gjuhe të vetme!”. Dallimi midis varianteve dialektore bese (trake) dhe dake, duke pasur që të dyja si burim IE **k^wun-abolo-* “qen-mollë”, provon se në transkriptimin e glosave mund të ketë devijime të konsiderueshme. Kështu, varianti dak, i transkriptuar me velaren (grykoren) nistore *k-*, ndjekur nga një zanore e përparme, *duhet të ketë pasur në të vërtetë një shqiptim palatal (qiellzor)*, i afërt me një bashkëtingëllore afrikate (**ts / *tz*), siç tregohet nga variantet bese, të transkriptuara në mënyrë alternative si *d-* ose *s-*. Ky transkriptim “*i kundërt*”, në kundërshtim me evoluimin e pritshëm të një gjuhe të tipit satem, është vënë re edhe nga Georgiev-i³⁹, i cili vëren se toponimi dak *Germisera* paraqitet i transkriptuar edhe në variantin *Germigera*, që tregon se një bashkëtingëllore latine *g*, e ndjekur nga zanoret e ose *i*, shqiptohet në të vërtetë (*d*)z ose (*d*)zh. Varianti i mëvonshëm, *Zermizerga*, dëshmon evoluimin fonetik specifik të gjuhës shqipe, me kalimet **g^whe- > *dze- > zja- dhe s-> z-> gj-*. Vëzhgimet e Georgievit relativizojnë vlerën e argumentit të paraqitur nga Matzinger-i, i cili, duke u nisur nga glosa trake *genton* “copë mishi”, nga IE **g^whend-* “godas, vras”, dhe toponimet *Germania*, *Germi-sara*, sipas IE **g^whermo-* “i ngrohtë”, përjashton prejardhjen e shqipes nga gjuhët trake⁴⁰.

Glosa bese, e shkruar në mënyre alternative *dinupula* dhe *sinupula*, me *d-* dhe *s-* për **ts-*, si dhe variantet e toponimit *Dierna*, *Tierna*, *Zerna*, për variantin e saktë *Tsierna*, tregojnë se në Ballkanin qendror afrikatat **ts-* dhe **dz-* shpesh janë transkriptuar duke përdorur dentalët (dhëmborët) *d-*, *t-* ose, më rrallë, *th-*. Kështu që bie argumenti i Matzingerit⁴¹ kundër etimologjisë për emrin e krahinës së Dardanisë, i cili për qiellzoren

³⁸ Matzinger 2016 fq. 15; Duridanov 1985 fq. 12

³⁹ Georgiev 1960 fq. 13

⁴⁰ Matzinger 2012 fq. 642-644

⁴¹ Matzinger 2016 b fq. 42 “Interpretimi i hasur shpesh i emrit tashmë antik Dardania nëpërmjet termit shqip “dardhë” nuk mund të mbështetet, sepse të gjitha etimologjitë e propozuar bazohen në leksema me IE **g^wh-*, që në stër-shqipe u

(palatalen) *ǵh-, e përligjur etimologjikisht, do të kishte pritur një transkriptim me sibilante (fërkimore) z ose s. Për më tepër, *transkriptimi me dentale (dhëmbore) i palataleve*, i shoqëruar në shumicën e rasteve edhe nga variantet me sibilante (fërkimore), përbën një *tregues të rëndësishëm, një shënues*, për praninë e shqipfolësve! Etimologjia e propozuar nga Detschew dhe Russu për Dardaninë është nga IE **dhereǵh-* “mbaj, fort”, rrënjë nga e cila vjen edhe teonimi trak *Darzas*, antroponimet trake *Derzus*, *Derzeilas*, *Derzizenus*, *Dardizanus*, *Derzenus*, *Derdidas*, *Derdipilus*, *Derdizanis* si dhe emri trako-maqedonas *Derdas*.⁴²

Rrjedhimisht, mund ta konsiderojmë të saktë edhe etimologjinë e propozuar nga Detschew për termin -*denth-*, -*dent-*, -*zenth-* “fis, farë, klan”, nga IE **ǵen-* “lind, gjeneroj”, **ǵent-* “komb, fis”, i cili gjendet edhe në emrin fisnor *Dentheletai (Dantheletai)*, si dhe në antroponimet trake të tipit *Denthis*, *Dentis*⁴³, *Dandes*, *Dendu*, *Denduporis*, *Dentu*, *Dindi*, *Dentusucu*, *Derodenthis*, *Dorzenth-* ose *Bessodenth-*. Russu përmend te ilirët variantin *Dando*, si dhe të përbërën mesape *denth-* (*denthehes*, *denthehides*). Nga e njëjta rrënjë IE del edhe fjala shqipe *dhëndër*, e cila tregon evoluimin nt > nd, që në rastin e termave trakë shprehet me alternimin nt / nth.

Një tjetër emër trak që reflekton përmendjen në mënyre alternative, me sibilante ose dentale për një afrikate, është emri i mbretit të trakëve *Denthelatai*, **Sitas**, një emër i dëshmuar edhe në variantet e mëposhtme: *Sittas*, *Tzita*, *Tzittas*, *Thithi*, *Thiti*, *Titi*, *Tittha*, *Thithis*. Origjina e emrit është rrënjja IE **k^wei-(t)-* “vëzhgoj, nderoj, vlerësoj”, nga dhe **k^wei-ti-* “mirëkuptim, nder”, rrënjë nga e cila vjen dhe greqishtja *atizo* “nuk nderoj”, *aor. etisa* “i nderova”, *poli-titos* “shumë i nderuar”, sanskritisht *cití-* “mirëkuptim”, *cítí-* “mendim, ndërgjegje”, bullgarishte e vjetër *čbtq*, *čisti* “numëroj, llogaris, lexoj, nderoj”. Identiteti në planin IE ndërmjet greqishtes *time* “adhurim, nder”, bullgarishtes së vjetër *čbstb* “idem” dhe sanskritishtes *cítí-h* “idem”, tregon ekzistencën e një termi të rëndësishëm, me përhapje dhe përdorim të gjerë. Evoluimi fonetik është specifik për shqipen, sipas fjalës shqipe **k^wih->*tsi>* si,⁴⁴ pra në lashtësi vlente varianti me afrikate (*tsi), i cili qëndron në bazën e variantit me s, z, t ose th. Nga e njëjta rrënjë rrjedhin variantet e shkurtra të emrit, të cilët dalin edhe në emra të përbëra të tipit *Sia-*, *Si-*, *Sei-*, *Zia-*, *Zi-*, *Thia-*, **Tia-** (sipas mbishkrimit të sipërpërmendur **Ulkas**, i biri i **Tias**): *Sia-maus*, *Tia-maus*, *Thia-markos*, *Sei-talkes*, *Si-burrenus*. Një *Zimarkos* i famshëm është shoqëruesi i Justinit, perandorit të ardhshëm romak, me të cilin rreth vitit 470 u largua nga rajoni Scupi-Naissus për në Kostandinopojë i shoqëruar nga një tjetër trak i quajtur *Ditubistos*. Termat ilirë, që ndoshta kanë në bazë të njëjtën rrënjë, janë: *Citua*, *Situa*, toponim dalmat, *Cittunis*, antroponim dalmat, *Cittu* antroponim dardan.

Një variant i nazalizuar (hundor) i emrit *Sitas*, (*Tzittas*) është **Thintas**, i regjistruar edhe si *Tzinta*, *Tsinta*, *Cintis*, *Zinnas* - nga e njëjta rrënjë IE rrjedhin edhe termat e bullgarishtes së vjetër *čēna* “nder, çmim”, *čēniti* “nderoj, çmoj” sanskritisht *cintā* “shqetësime, mendime”. Emri ndoshta qëndron edhe në bazë të emërtimit të fisit trak *Sintoi*. Ky fis ka banuar në një zonë të ndodhur në veri të gadishullit *Athos*, afërsisht në zonën kufitare midis Bullgarisë dhe Greqisë. Në veri të *Sintëve* u vendosën fiset *Maedi*, fqinjët jugorë të trakëve *Dentheletai*. Antroponimi *Thintas* përmendet nga S. Olteanu në artikullin “Palatala TDM (Trako-Dako-

kthye në *dz dhe respektivisht më vonë në *dz, gjë që e riprodhuar në dokumentet grekë / latinë do të kërkonte një refleks përkatës pra diçka të tipit <z>, <s>, ose të ngjashëm.”

⁴²Russu 1969 fq. 192, 205; Detschew 1957 fq. 117-119, 127; Dana 2014 fq. 112, 123-124

⁴³Russu 1941 fq. 110, *Dentis* (Dobruşovo, 20 km në verilindje të Manastirit, Maqedoni e Veriut)

⁴⁴Matzinger 2006 fq. 72

Miz)⁴⁵: “i dëshmuar dy herë në Sofie (IGB IV, 1963 și 2004), shfaqet rreth pesë herë në mbishkrime latine të dakëzuara (në rumanisht *dacizante*) në format *Tzinta*, *Tzinto* dhe *Tsinta*. Kemi të bëjmë me alternimin tipik, th/tz (ts), pra bashkëtingëllozja nistore është me siguri qiellzorja (palatalja) trake [ç]”. Duke marrë parasysh evolucionin **nt** > **nd** > **nn** > **n** tipik për shqipen, (dakisht *mantia* > shqip *mand* > *man*), emrat trakë ***Tsinna***, ***Zinna***, ***Sinna*** duhen konsideruar si forma të mëvonshme të të njëjtit emër, **Tsintas*. Në Dardani dëshmohet emri *Cinna*, kurse Russu shënon te ilirët antroponimet *Thintas*, *Sinna*, *Sinnius*.

Emri shqiptar *Sina*, i dëshmuar edhe në toponimet “*Sina e sipërme / poshtme*”, është i pranishëm edhe te arumunët, prej nga vjen familja Sina, me origjinë nga Voskopoja, e fisnikëruar në Perandorinë Austro-Hungareze. Një tjetër bartës i famshëm i këtij emri ishte Sinan Pasha, Vezir i Madh osman me origjinë shqiptare.

Me shkrim alternativ paraqitet edhe emri i mbretit *Tipas* të trakëve të fisit *Maedoi*, nga të cilët ka prejardhjen gladiatori Spartakus, emër i dëshmuar edhe në trajtat *Sipa*, *Sipia*, *Sippia*, *Sippas*, *Thipis*, *Zipas*, *Zipakenthos* kurse në Shqipëri, zona e Korçës, dëshmuar në variantin *Tippakos*.⁴⁶

Shembulli i fundit është antroponimi trak ***Tsiru***, i përmendur në një epitaf nga *Capidava*, (Dana 2014 f. 380): “*Basso patri et Tsinnae fr(atri) Zura et Tsiru posuerunt*”. Rrënja më e mundshme e këtij antroponimi është IE **k^wē[ij]-(ro)*- “vëzhgues, mbrojtës, rojtar”, nga ku rrjedhin edhe termat grekë *tiros* (τηρός) “mbrojtës, ruajtës” dhe *tireo* (τηρέω) “vëzhgoj, ruaj, përgjoj”. Variantet me një sibilante nistore të të njëjtit term janë ***Serres***, kryeqyteti i fisit peonik ***Siro-paiones***, ***Sires***, një fis trak në perëndim të Bizantit, emërtime që mund të lidhen edhe me pjesën e dytë të antroponimit mesap *Bala-sires* (*Bala-sirihi*) si dhe me antroponimin *Sirras*, i konsideruar si ilir ose maqedonas⁴⁷.

Më poshtë është një listë me ndryshimet fonetike që kanë ndodhur në gjuhën shqipe, e ndjekur nga bashkëpërkimet nga trakishtja ose ilirishtja:

* <i>e</i> > <i>ie</i> , <i>ia</i>	* <i>dhegh</i> - “djeg” > <i>Diegis</i> , emër dak, <i>Kebros</i> > <i>Kiabros</i> , hidronim në Mezi
* <i>o</i> > <i>a</i>	* <i>spor-</i> > * <i>spara-</i> “farë, fis” > <i>Sparadokos</i> , emër trak
* <i>ə</i> > <i>a</i>	* <i>dhə-</i> “rri” > <i>dava</i> , në të përbëra të tipit <i>Buridava</i> , toponim dak
* <i>ā</i> > <i>o</i>	* <i>mā-</i> “i mirë” > <i>Monunios</i> , antroponim ilir dhe trak ⁴⁸
* <i>a-</i> > <i>0</i>	* <i>akua-dam-a</i> > <i>koadama</i> , fitonim dak, rënia e a-së e patheksuar
* <i>ō</i> > <i>e</i>	* <i>Pōlōndava</i> > <i>Pelendova</i> , toponim dak
* <i>au</i> > <i>a</i>	* <i>dhau-</i> “mbys” > <i>dakina</i> “zemër ujku”, fitonim dak
* <i>k̂</i> > <i>ts</i> > <i>th</i>	* <i>k̂er-no-</i> “akull” > <i>Dierna</i> , <i>Tsierna</i> , <i>Tierna</i> , toponim dak
* <i>ĝh</i> > <i>dz</i> > <i>z</i>	* <i>ĝent-</i> “fis” > <i>Dentheletai</i> fis trak, <i>Denthis</i> , <i>Dando</i> emër trak dhe ilir
* <i>s</i> > <i>z</i> > <i>gj</i>	* <i>ser-</i> “rrjedh” > <i>Germi-zera</i> dhe <i>Germi-gera</i> , toponim dak

⁴⁵ S. Olteanu 2008, <http://soltm.com/langtdm/phon/palatala.htm>

⁴⁶ Anamali 1992 fq. 60

⁴⁷ Russu 1969 fq. 248

⁴⁸ Mbreti ilir *Moniunos* dhe vëllai i princit trak Ketrporis, *Moniunos*

*su- > v	*sue-t- “vetë” > *huaitā- > <i>Vet-esprios, Ouet-esprios</i> , antroponim trak
*g^whe-> dze > ze	*g^whermo- “ngrohtë” > <i>zermi-</i> , në <i>Zermi-zirga</i> , toponim dak
*k^wih- > tsi > si	*k^wei-t- “nder” > <i>Tsintas</i> emër trak, <i>Sina</i> emër shqiptar
*nt > nd > nn > n	*k^wei-t- “nder” > <i>Tsintas</i> > <i>*Tsinda</i> > <i>Sinna</i> , emër trak dhe ilir
*ŋ > a	*mŋ-t- “mal” > <i>Mati, Mathis</i> , oronim trak dhe ilir
*ɣ > ri	*k^wɣ(ə)so-s “i zi” > <i>Krisos</i> , lumë në Daki
*sk > kh > h	<i>Scorylo</i> > <i>Coryllus, Skapsa</i> > <i>Kapsa</i> , antroponim dak, toponim trak
*sp -> p- > f-	*spor-> *spara- “farë, fis” > <i>Pardokas</i> , emër trak
*sr- > str-	*sreu- “rrjedh” > <i>Struma</i> , lumë në Traki, <i>Sistris</i> ishull në Dalmaci
*sn > n	*sn-et- “rrjedh”, “lëng” > <i>Nestos</i> , lumë në Traki
*sm > m	*dies-eusmŋ > <i>diesema</i> “lëpushkë”, fitonim dak
*kr- > kr-	*krā- “pjesa e sipërme, koka” > <i>Krobizoi</i> , fis get
*d-t > ss > s	*sal-d-t “kripë” > <i>Salsovia</i> , toponim dak
*-n- > -r-	<i>Zioncellus</i> > <i>Tziorikkelos</i> , degë e lumit Erigon
*n -infix	*k^wei-t- “nder” > <i>Tsintas</i> , <i>Diegis</i> > <i>Diengis</i> , emër trak / dak
(*b > *p)	*kun-abolo- “mollë, qen” > <i>dinupula</i> “stërkungull”, glosë bese
(*d > *t)	*doru- shtizë” > <i>Taru-thinas</i> “mbajtës i shtizës”, emër trak
(*g > *k)	*guel(ə)- “buron” > <i>Saldo-kela</i> toponim trak

Tre dukuritë e fundit fonetike, mutacioni bashkëtingëllor b, d, g > p, t, k, i parashtuar nga Georgiev-i dhe Duridanov-i në rastin e gjuhës trake, i gjejmë në gjuhën shqipe vetëm në rastin e disa fjalëve të caktuara dhe kryesisht në dialektin juglindor të toskëve⁴⁹. Në rastin e gjuhës trake konstatohet një situatë e ngjashme me atë të shqipes, dukuria e mutacionit bashkëtingëllor vlen vetëm për një numër të kufizuar fjalësh. Për këtë arsye, Matzinger-i mohon ekzistencën e këtij fenomeni tek trakët⁵⁰, ndërsa Kortlandt-i e pranon atë⁵¹. Kjo dukuri fonetike e përbashkët për gjuhën trake dhe shqipen duhet interpretuar veçanërisht në kuadrin e bashkëjetesës së trakëve dhe ilirëve në rajonet e fqinjësisë trako-ilire, si dhe duke marrë parasysh bashkëpërkimet e shumta leksikore trako-shqiptare.

Nga ana tjetër, mund të diskutohet për një ndikim të mundshëm ilir te trako-dakët, duke marrë parasysh praninë tek dakët dhe trakët e një tipi onomastik me -o, -on, specifik për ilirishten. Pjesa fundore e emrave ilirë të tipit *Bato, Biso, Dasto, Ditio, Nando, Verzo*, etj. - haset qysh herët edhe te dakët: *Charnabon* (shek. V p.e.s.), *Moskon* (shek. III p.e.s.), *Koson* dhe *Cotiso* (shek. I p.e.s.). Tek trakët mund të përmenden mbretërit mitikë *Biston, Edon, Paion* dhe *Maron*, ndoshta edhe emri i fisit *Derrones*.

Në zonat e kontaktit trako-ilir shënohen gjithashtu një sërë antroponimesh të përbashkëta për dy etnitë. Kështu emri ilir *Genthius* del edhe tek trakët *Ditugenthis, Keligenthis* kurse emri i mbretëreshës ilire *Teuta* shfaqet tek

⁴⁹ Topalli 2007 fq. 410-412, gropë < *ghrebh-; petk < *baita; mjet < *medhio; etje < *ajdh-; tym < *dheu-, dheuə-; ikëj, iki < *ei-gh-

⁵⁰ Matzinger 2012 fq. 642

⁵¹ Kortlandt 1988

trakët në formën *Tiouta, Tioute, Touta, Tautomedes* dhe *Teutamados*. Përcaktues për përzierjen e dy etnive është emri *Bardibalus*, i zbuluar 36 km në jug të Beogradit, emër i konsideruar nga Russu si “trako-ilir”, sepse elementi *bard* - gjendet vetëm te ilirët, kurse elementi fundor - *balus*, vetëm tek trakët.⁵²

Kuptimi i elementit nistor *bard-*, sipas propozimeve të paraqitura nga Katičić-i dhe Matzinger-i,⁵³ rrjedh nga IE **bhardhā-* “mjekër”, veçanërisht pasi një emër i ngjashëm, *Scenobardus*, u transkriptua nga romakët përmes *Scenobarbus* (sipas latinishtes *barba* “mjekër”). Në këtë mënyrë, emri i mbretit dardan *Bardulis* duhet përkthyer si “burrë, trim”, kuptim që përmes një kalku semantik ka hyrë edhe në rumanisht, ku do të thotë edhe “trim, guximtar”, siç e dëshmon shprehja rumune *câine bărbat* “qen trim (burrë)”. Emri *Bardibalus* rrjedhimisht duhet të ketë kuptimin “prijës-trim” me elementin fundor që përkon me fjalën shqipe *ballë*. Fakti që proto-rumanishtja ka huazuar një ndërtim semantik ilir shpjegohet me bashkëjetesën mes trako-romakëve dhe ilirëve.

Një tjetër tipar i përbashkët i trakëve dhe ilirëve është prapashtesa **-tai* (në shkrimin grek), e konsideruar nga Dan Slușanschi⁵⁴ si një formant shumësi që gjendet si në toponimin *Drubeta* (**druweta*) ashtu edhe në emrat e fiseve trake si *Dantheletai, Koilaletai, Arsietai* ose *Piengitai*. Slușanschi sjell në vëmendje gjithashtu edhe afërsinë me formantin sllav *-ta*, me atë iraniane *-tae* (*Sarmatae*) dhe me shumësin në shqip *-t*. Kjo prapashtesë është po aq e përhapur edhe tek ilirët, ajo gjendet tek emrat e fiseve të rëndësishme si *Autariatai, Dalmatai, Dassaretai, Dokleatai* ose *Labeatai*. Fisi *Thunatai*, fqinji perëndimor i trakasve *Maidoi*, konsiderohej ilir, trak (sipas fiseve trake *Thynoi* dhe *Bithynoi*) ose trako-ilir. Eric Hamp-i (1982) identifikoi në toponimin *Drubeta*, të cilin e lidhi me shqipen *drutë* (shumës), rumanisht *druete* “buzm, dru i trashë”, një dëshmi për ekzistencën e nyjës së shquar të prapavendosur tek dakët.

Qëllimi i këtij shkrimi është të hedhë dritë mbi faktin se ekzistojnë bashkëpërkime të shumta dhe të rëndësishme trako-shqiptare dhe iliro-shqiptare. Pohimi i Çabejit, sipas të cilit gjurmët e lidhjeve mes shqipes dhe ilirishtes janë më të shumta - 26 përkime krahasuar me 10 bashkëpërkime me trakishten (fusnota nr. 11) - nuk mund të konfirmohet, përkundrazi ka një raport rreth 2.5 : 1 në dobi të bashkëpërkimeve me gjuhën trake, përpjesëtim që pasqyrohet edhe në raportin ndërmjet mbetjeve gjuhësore të gjuhës trake dhe ilire. Ky konstatim nuk bie domosdoshmërisht në kundërshtim me tezën e prejardhjes së gjuhës shqipe nga ilirishtja, por vërteton të paktën - siç kanë pohuar edhe Çabeji edhe Brâncuș-i - një komponent domethënës trak në gjuhën shqipe. Ky përfundim, natyrisht, i referohet vetëm përbërjes së gjuhës shqipe, sepse, nga pikëpamja etnike, shqiptarët janë me siguri kryesisht pasardhës të ilirëve, të cilët kanë jetuar në trevat ku jetojnë sot shqiptarët.

Radu Crăciun (Krëçun) – radu.craciun@yahoo.com

Anamali 1992 - Skënder Anamali, *Antroponimia ilire në mbishkrimet e lashta të krahinave të Tetovë-Gostivarit, Dibër-Kërçovës dhe Strugë-Ohrit*, 1992.

Barić 1959 - Henrik Barić, *Istorija arbanaskog jezika*, DJELA Knjiga XII, 1959

Brâncuș 1991 - Grigore Brâncuș, *Istoria cuvintelor - Unitate de limba și cultura românească*, Coresi, 1991

Brâncuș 2009 - Grigore Brâncuș, *Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române*, 2009

⁵² Russu 1941 fq. 134

⁵³ Katičić f. 174; Matzinger 2021 fq. 159

⁵⁴ Wald, Slușanschi 1987 fq. 109, 117

- Çabej 1997** - Eqrem Çabej, *Mbi prejardhjen e popullit Shqiptarë*, revista Rilindja, Prishtinë 23.VII.1977
- Çabej 2008** - Eqrem Çabej, *Hyrje në Indoeuropianistikë*, Botime Çabej, 2008
- Çabej 2017** - Eqrem Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Botime Çabej, 2008, 2017, (botuar në gjuhën rumune: *Introducere în istoria limbii albaneze*. Editura Universității din București, 1997)
- Dana 2014** - Dan Dana, *Onomasticon Thracicum. Répertoire des noms indigènes de Thrace, Macédoine orientale, Mésies, Dacie et Bithynie*, Athena, 2014
- Detschew 1957** - Dimiter Detschew, *Die thrakischen Sprachreste*, 1957
- Duridanov 1963** - Ivan Duridanov, *Illyrische Flussnamen in Serbien*, LB VI., 1963
- Duridanov 1985** - Ivan Duridanov, *Die Sprache der Thraker*
- Ebert 1924** - *Reallexikon der Vorgeschichte* (15 vol.)
- Eichner 2004** - Heiner Eichner, *Illyrisch – die unbekannteste Sprache*, în *Die Illyrer. Katalog zu einer Ausstellung von archäologischen Funden der albanischen Eisenzeit*
- Gostentschnigg 2006** - Kurt Gostentschnigg, *Din Frage der albanischen Ethnogenese - Ein historischer Abriss ihrer Diskussion bis zum Ende des 20. Jahrhunderts*, în *Grazer Linguistische Studien* 66, 2006, p. 39-60
- Gostentschnigg 2018** - Kurt Gostentschnigg, *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär - Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867–1918*, Springer Fachmedien Wiesbaden GmbH, 2018
- Gostentschnigg 2019** - Kurt Gostentschnigg, *Die Diskussion der Frage der albanischen Ethnogenese - Ein historischer Abriss*, în *Albanische Forschungen* vol. 39, 2019, p. 51-74
- Hamp 1982** - Eric P. Hamp, *The oldest albanian syntagma*, în *Linguistique balkanique* XXV, Sofia, 1, 1982
- Hamp 2007** - Eric P. Hamp, *STUDIME KRAHASUESE PËR SHQIPEN*. Zgjedhja, përgatitja dhe parathënia R. Ismajli, Përkthyer: R. Ismajli, B. Rugova, Rr. Paçarizi, Sh. Munishi, G. Bërlajolli, B. Pllana. Prishtinë, 2007
- Iliev 2014** - Jordan Iliev, *The ancient Thracian origin of the name "Cepina"*, academia.com
- ILR 2018** - Academia Română, *Istoria limbii române – Volumul I*, 2018
- Ismajli 2015** - Rexhep Ismajli, *Studime për historinë e shqipes në kontekst Ballkanik*, Prishtinë, www.ashak.org/repository/docs/RISMAJLI_397704.pdf, 2015
- Jokl 1911** - Norbert Jokl, *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung*
- Katičić 1976** - Radoslav Katičić, *The Ancient Languages of the Balkans*, 1976
- Kortlandt 1988** - Frederik Kortlandt, *The Thraco-Armenian consonant shift*. *Linguistique Balkanique / Balkansko Ezikoznanie* 31 (1988), p. 71-74
- Malcolm 1999** - Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History*, Harper Perennial, 1999
- Mateescu 1925** - George G. Mateescu, *Granița de apus a tracilor: (contribuțiuni toponomastice și epigrafice)*, Institutul de Arte Grafice, 1925
- Matzinger 2006** - Joachim Matzinger, *Der altalbanische Text [E] Mbsuame e Krështerë (Dottrina Cristiana) des Lekë Matrënga von 1592, eine Einführung in die albanische Sprachwissenschaft*, Jenaer Indogermanistische Textbearbeitungen 3, 2006

- Matzinger 2007** - Joachim Matzinger, *Altalbanisch ujë „Wasser“ und die Kategorie der Massennomina bei Buzuku*, în volumul editat de Bardhyl Demiraj 2007: „Nach 450 Jahren: Buzukus "Missale" und seine Rezeption in unserer Zeit“
- Matzinger 2009** - Joachim Matzinger, *Die Albaner als Nachkommen der Illyrer aus der Sicht der historischen Sprachwissenschaft*, in: O. J. Schmitt, E. A. Frantz (Hgg.), *Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung*, München: Oldenbourg Verlag, S. 13-36, 2009
- Matzinger 2012** - Joachim Matzinger, *Zur Herkunft des Albanischen. Argumente gegen die thrakische Hypothese*, în: Studime për nder të Rexhep Ismajlit me rastin e 65-vjetorit të lindjes, 2012, Prishtinë: Koha, p. 635–649
- Matzinger 2016** - Joachim Matzinger, *Die albanische Autochthoniehypothese aus der Sicht der Sprachwissenschaft*, München, 2016
- Matzinger 2016 b** - Joachim Matzinger, *Die Altbalkanischen Sprachen*, 2016
- Matzinger 2021** - Andreas Lippert, Joachim Matzinger *Die Illyrer*, Kohlhammer, 2021
- Mirdita 1981** - Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë në kohën romake*, Prishtina, 1981
- Mócsy 1974** - András Mócsy, *Pannonia and Upper Moesia. A History of the Middle Danube Provinces of the Roman Empire*, Routledge, 1974
- Papazoglou 1978** - Fanoula Papazoglou, *The central Balkan tribes in pre-Roman times: Triballi, Autariatae, Dardanians, Scordisci and Moesians*, Hakkert, 1978
- Russu 1941** - Ion I. Russu, *Granița etnică între Traci și Illiri*, în Anuarul Institutului de Studii Clasice VOL. IV (1941-1943)
- Russu 1969** - Ion I. Russu, *Illirii. Istoria. Limba si onomastica. Romanizarea*, 1969
- Sharankov 2016** - Nicolay Sharankov, *Heraclea Sintica in the Second Century AD: New Evidence from Old Inscriptions*, în *Archaeologia Bulgarica XX*, 2, p. 57-74, 2016
- Schramm 1993**- Gottfried Schramm, *Anfänge des albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen*, Freiburg, 1993
- Theodossiev - Manov 1997** - Nikola Theodossiev, *Methodi Manov Rich Thracian Tumular Grave of Oulkos, Son of Tios*, în Actes 2e Symposium international des etudes thraciennes “THRACE ANCIENNE”, Komotini 1997, p. 365-390
- Topalli 2007** - Kolec Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Shtëpia Botuese Dituria, 2007
- Topalli 2017** - Kolec Topalli, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Tirana, 2017
- Vehbiu 2007** - Ardian Vehbiu, *Shqipja gjuhë e lashtë*, <https://peizazhe.com>
- Vehbiu 2012** - Ardian Vehbiu, *Protoshqipja në Ballkan II*, <https://peizazhe.com>
- Vehbiu 2020** - Ardian Vehbiu, *Gladiatorët e shqipes*, <https://peizazhe.com>
- Vehbiu 2021** - Ardian Vehbiu, *Cila autoktoni, cilët ilirë*, <https://peizazhe.com>
- Wald, Slușanschi 1987** - Lucia Wald, Dan Slușanschi, Francisca Băltăceanu, *Introducere în studiul limbii și culturii indo-europene*
- Wilkes 1995** - John Wilkes, *The Illyrians. The Peoples of Europe.*, Wiley & Sons Ltd., 1995